



Fletëudhëzim mbi ligjin për ndihmë ndaj viktimës (OHG)

Ky fletëudhëzim u drejtohet femrave/grave të cilat kanë përjetuar dhunë trupore dhe/ose psikike nga bashkëshorti, partneri/-e ose ishpartneri/-e.

Drejtat të përgjithshëm

- Si grua e prekur mund të zgjedhni nga cila konsultore për ndihmën e viktimave, që është e njohur nga kantoni, keni dëshirë të pranoni mbështetje. Ju e gëzoni drejtën për këshilla juridike, sociale dhe psikologjike.
- Shërbimet e konsultorës janë falas. Këshilltaret i nënshtrohen detyrimit mosfoljes. Marrja e mbështetjes është e pavarur nga një lajmërim penal.
- Varur nga rrethanat financiare mund të financohen **pjesëpaguesa në lidhje me shërbime ndihmës të tretëve** (p.sh. shpenzime terapisë, shpenzime për strehë emergjence etj.).
- Mbrenda 5 vitëve prej veprimit fundit penal ju mundëni ndër kushte të caktuar ta bëhëni një kërkesë për **zhdëmtim financiar** (p.sh. ndërprerja e fitimit) dhe **dëmshpërblim**. Ky afat vlen për vepra penale, që janë bërë mbas 1.1.2007.

Në rastin e një procesi penal ju e gëzoni drejtën:

- tek marrja në pyetje në polici edhe në prokurori të jeni e shoqëruar nga një person i besimit
- të kërkonit, që marrja në pyetje të jetë pa pranin e fajësuarit
- deklaratë të refuzoni në pyetje mbi sferën intime
- të kërkonit, që vendime të rëndësishëm, p.sh. lirim nga burgimi, pezullim i ndalim kontakti etj., tju lajmërohen

Nese keni përjetuar dhunë seksuale, ju e gëzoni drejtën shtesë:

- të kërkonit, që marrja në pyetje në polici edhe në prokurori dhe përkthimi i saj të bëhëni nga një femër
- të kërkonit, që mos tu ballafaqoni me fajësuarin gjatë tërë procesit penal
- të kërkonit, që publiku të përjashtohet nga pjesëmarrja në procesin gjyqsor

Fletëudhëzimi është dërguar nga, Cyrih me 2011-01-11